



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME BUJQËSORE “RAKIP KRYEZIU” FIER

Nr. 92 prot.

Fier, më 22.8.2025

Lenda: Njoftim për levizje paralele

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
TIRANË**

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhezimit nr. 759 date 30.09.2024

"Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit"

Ofruesi publik i AFP-së, Shkolla e Mesme Bujqësore “Rakip Kryeziu” Fier, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

- **Mësimdhënës i teorisë dhe praktikës profesionale në drejtimin Shërbime Mjete Transporti**

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale duhet të përmbushë këto kriteret:

1.1 Kriteret e përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

1.2. Kriteret e posaçme:

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në fushën e Inxhinierisë mekanike

Shkolla e Mesme Bujqësore “Rakip Kryeziu” Çlirim/Fier Rr. Fier-Seman Km3
e-mail: shkollabujqesorefier@live.com

- b) të ketë të paktën 1 (nje) vite përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në) sipas modelit Europass,
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën e studimeve universitare ;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në sekretarinë e shkollës, brenda datës (5 ditë pune nga publikimi i shpalljes).

01.09.2025

DREJTORI I SHKOLLËS
Alket MERDANAJ

